



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

01-  
020-807/7  
17.07.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije  
Ministry of Local Government Administration

Nr.  
Br.  
No.  
Datë  
Datum  
Date

<b>Për :</b>	<b>Ragip Begaj</b> , Kryetar i Komunës së Malishevës <b>Rrahim Morina</b> , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës
<b>Cc:</b>	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë
<b>Përmes:</b>	<b>Ivan Todosijević</b> , Ministër i MAPL-së <i>pp BF. [signature]</i> <b>Rozafa Ukimeraj</b> , Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së <i>[signature]</i>
<b>Nga:</b>	<b>Shkelqim Jakupi</b> , Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL- <i>[signature]</i> Datë: 10.07.2018
<b>Lënda:</b>	Konfirmim i ligjshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës Nr. 020-807
<b>Lloji i aktit</b>	Vendim

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 02/258 në parim për miratimin e kërkesës së banorëve të lagjes "Hoti" në Malishevë
I miratuar më datë: 03.07.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.07.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

<b>Për :</b>	<b>Ragip Begaj</b> , gradonačelnik Opštine Mališevo <b>Rrahim Morina</b> , predsedavajući Skupštine opštine Mališevo	
<b>Kopija:</b>	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
<b>Preko:</b>	<b>Ivan Todosijević</b> , ministar MALS-a, <i>z. B. T.</i> <b>Rozafa Ukimeraj</b> , generalna sekretarka MALS-a, <i>[Signature]</i>	
<b>Od:</b>	<b>Shkelqim Jakupi</b> , direktor Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS - <i>[Signature]</i>	Datum, 10.07.2018. Br. 020-807
<b>Predmet:</b>	Zahtev za razmatranje odluke Skupštine opštine Mališevo	
<b>Vrsta akta:</b>	Odluka	

Poštovani gradonačelnice,  
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samouprav kao u nastavku:

Odluka br. 02/258 u načelu za usvajanje zahetva stanovnika naselja "Hoti" u Mališevu
Usvojena dana, 03.07.2018. godine,
Predložena za razmatranje u MALS-u, dana, 06.07.2018. godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon rasprave gore navedenog sadržaja akta opštine, procenjuje da je isti u proceduralnom aspektu u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravne efekte pošto se dopunjuje sa još jednim članom od strane izvršne vlasti. Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo koje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

HYRËSE - ULAZNA - UVEDENING KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË DEKRETI I KOMUNËS PËR DREKTORIN E KUVENDIT			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministertvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration			
Data Date		06.07.2018	
Përfaqësimi i Komunitetit Representation of the Community		-VI- 070-007	

Kuvendi i Komunës  
Nr.02/  
Datë: 05.07.2018

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenit 24 dhe 40 paragrafi 2 pika c, të Ligjit nr.03/-040 për Vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15 qershor 2008), Rregullores nr.02/244 datë:09.09.2015 për ndarjen e subvencioneve dhe transferëve, në bazë të nenit 19 paragrafi 1 pika a, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës 12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në vazhdimin e mbledhjes së VII (shtatë) të mbajtur më datë: 03.07.2018 merr këtë:

V E N D I M  
NË PARIM PËR MIRATIMIN E KERKESËS SË BANORËVE TË LAGJËS "HOTI" NË  
MALISHEVË

1. Miratohet në parim vendimi sipas kërkesës nr.02/125 datë:27.04.2018, e parashtruar nga banorët e lagjes "Hoti" në Malishevë, për ndarjen e mjeteve financiare për rregullimin e varrezave.
2. Bazuar në pikën 1 të këtij vendimi ndarja e mjeteve për rregullimin e varrezave të lagjes "Hoti" do të bëhet në bazë të rishikimit të buxhetit të Komunës së Malishevës për vitin 2018, ose nga bashkëfinancimi me qytetarë 30% nga Komuniteti, dhe 70% nga Komuna.
3. Realizimi i vendimit do të bëhet duke u respektuar procedurat e prokurimit publik, bazuar në specifikacionin dhe vlerën e projektit dhe duke u mundësuar banorëve tjerë përreth të pronave private qasje të pa penguar në rrugë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe shërbim pronësor juridik dhe Drejtorisë për Shërbime Publike.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:  
Arkivit të Komunës  
Drejtorive të KK-së  
MAPL-së.

Kryesuesi i Kuvendit  
Rajmir Morina